



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 338/25 Dt. 04.06.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi


Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), neni 10 i Rregullores Nr.001/011 – 113879, të datës 29 korrik 2022, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe neni 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Kryetari i Komunës, merr këtë

V E N D I M

Për formimin e komisionit

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim në më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës, sipas Rregullores nr.001/011 – 113879, të datës 29 korrik 2022, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës. Anëtarë të Komisionit emërohen:
 - Afërdita Mormorina,.....kryesuese e Komisionit – DUPH,
 - Samir Pireci,.....anëtar i Komisionit – DSHP,
 - Nuhi Kadolli,.....anëtar i Komisionit – DI.
- Mandati i anëtarëve të Komisionit do të jetë dy (2) vite, konform neni 10, paragraf 5 të Rregullores nr.001/011 – 113879, të datës 29 korrik 2022, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- Detyrat e Komisionit do të jenë shqyrtimi i kërkesave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, për periudhën më pak se një (1) vit.
- Komisioni do të filloj punën menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe për punën e tij do t'i raportoj me shkrim kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.